

**Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përherëshëm**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DROPULL  
KËSHILLI BASHKIAK**

(Adresa, \_\_\_\_\_ nr. Tel \_\_\_\_\_, e-mail \_\_\_\_\_)

**Komisioni i Përherëshëm për “Barazi gjinore, mosdiskriminimit të drejtave të njeriut dhe mireqenies sociale”**

**RAPORT VENDIMMARRJE**

Nr. 3 datë 30.03.2026

Nr. 623 Prot

**Drejtuar:** Këshillit të Bashkisë

**Lenda:** Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 3 datë 31.03.2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për “Per miratimin e perfituesve te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar te ndihmes ekonomike per muajin Mars 2026 “.

**Analiza ligjore:** (bazueshmëria ligjore):

Nëmbështetje të nenit 24, “Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale”, Ligji 139/2015, “Mbi vetqeverisjen vendore”, nenit 21, të Ligjit 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKMnr.597, datë 04.09.2019, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.68, dt.17.12.2025, “Për miratimin e kriterëve për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike, për familjet dhe individët në nevojë, për vitin 2026”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.68, dt.17.12.2025 me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**Situata aktuale e funksionit** (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit):

Drejtorja e Shërbimeve Sociale dhe e Strehimit, në bashkëpunim me kryetarët e fshatrave dhe administratorët e tre njësive administrative, vazhdon punën për evidentimin e familjeve dhe individëve në nevojë më të ngutshme për të përfitur nga fondi mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike. Ky proces është dinamik, pasi kushtet dhe rrethanat e jetesës së pjesëtarëve të komunitetit tonë ndryshojnë vazhdimisht. Pas kryerjes së identifikimit, individët në nevojë, janë nxitur për të bërë kërkesë për aplikim në Sistemin Elektronik Kombëtar për Ndihmën Ekonomike, nëpërmjet administratorëve shoqërorë, që kemi në të tria Njësitë Administrative. Aplikimet dhe riaplikimet e reja gjatë 10-ditorit të parë të muajit Mars 2026, u kryen në tre njësitë administrative (Dropull i Sipërm, Dropull i Poshtëm dhe Pogon). Nga ana e administratorëve shoqërorë vazhdojnë të bëhen të gjitha përpjekjet, që në listën e perfituesve të përfshihen të gjithë familjet dhe individët në nevojë sipas kriterëve të miratuara nga ana e Këshillit të Bashkisë, por edhe të hiqen nga kjo listë ata që për arsye të ndryshme, si rifutja në skemën elektronike të ndihmës ekonomike, ata që largohen në emigracion për shkak të kushteve të vështira për tu vizituar nga fëmijët dhe të afërmit, atyre që u ndryshojnë kushtet e jetesës, atyre që rezultojnë me mospërputhje gjatë deklarimit tremujor, etj

**Situata financiare :** (Shtesa / pakësime në buxhet) :

Parat janë të garantuara nga të ardhurat e Bashkisë Dropull në Programin Buxhetor Perkuajdesi Social (10430), është miratuar një fond prej 3.800 mijë lek, në artikullin 606 (shpenzime për familje dhe individë), të cilat do të përdoren për familjet dhe individët në nevojë, përgjatë vitit 2026, duke i miratuar me vendime të përmuajshme të Këshillit Bashkiak.

**Drejtoria / Sektori përgjegjës:**

**Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe e Strehimit**

**Monitorimi dhe raportimi :** (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh): **Komisioni i Përhershëm për "Barazi gjinore, mosdiskriminimit të të drejtave të njeriut dhe mirëqenies sociale"**, dhe keshilli bashkiak, çdo muaj dhe sa here që ata e shohin të nevojshme

**Impakti social / grupet që preken:**

Grupet që preken janë familjet ose individët që nuk kanë asnjë të ardhur, ose të ardhura të pamjaftueshme (deri në nivelin e pages minimale bruto), të jenë individë të vetmuar pa asnjë të ardhur, nën moshën e pensionit, që kanë probleme të theksuara të varferisë, të jenë pensionistë të vetmuar, të braktisur, ose çift pensionistësh me probleme të theksuara shëndetësore.

**A është objekt i konsultimit publik: Jo**

Komisioni i Përhershëm për “Barazi gjinore, mosdiskriminimit të drejtave të njeriut dhe mireqenies sociale”, i mbledhur me datën \_\_\_\_\_2026\_\_, shqyrtoi projekt vendimit nr. \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_2026\_\_, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin “Per miratimin e perfituesve te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar te ndihmes ekonomike per muajin Mars 2026 “. “ paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni e me shumicë votash,

### VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak:

a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim

b) miratimin e projektaktit

c) refuzimin e miratimit të projektaktit


d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:


✓ Pika 1 (një) e projekt vendimit të ndryshoje në “-----“

✓ Pika 4 (katër) e projekt vendimit të ndryshoje në “-----“

✓ Tabela nr. 6 (gjashtë) e projekt vendimit të ndryshoje në “-----“

✓ Paragrafi 15 (pesëmbëdhjetë) i projekt vendimit të ndryshoje në “-----“

  
(emri, mbiemri, firma) Kryetar i Komisionit

  
(emri, mbiemri, firma) Sekretar i Komisionit

Datë 30.03 2026